

Emertimi i shoqerise dhe forma ligjore : AGROCON ALBANIA sh.p.k  
NIPT : L324060240  
Adresa e selise : Rruga e "Kavajes" prane godines Plus,ish Misto Mame  
Data e krijimit : 06.12.2013  
Veprintaria kryesore : Sherbime publike te komunikimeve elektronike

**PASQYRAT FINANCIARE**  
( Në zbatim te SKK nr.2 dhe Ligjit Nr. 9228, dt.29.04.2004 `` Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare`` )

Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare 01.01.2016 deri 31.12. 2016

Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare : 31.12.2016

Pasqyrat Financiare janë individuale : Individuale  
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara : Te Pakonsoliduara  
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në : LEK  
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullaksura në : 0 Lek

AGROCON ALBANIA  
Sh.p.k.  
Nipt : L 32406024 O  
TIRANË - ALBANIA

Tiranë, më 31 Mars 2017

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Drejtuar: Ortakut të shoqërisë “Agrocon Albania” sh.p.k.**  
Rruga “Sneh Ahmet Pazarit”, Njësia bashkiake nr.2,  
Pallati Ambasador 2, Njësia nr.10, Kati 1-rë,  
Tiranë

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare “Agrocon Albania” shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2016, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar, si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me administrimin e Shoqërisë, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të saj.

#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Venis-Audit & Financë sh.p.k.

Vera Lala  
Administrator



Vera Lala  
Auditues Ligjor

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) 31 Dhjetor 2016				në lekë
	Zëri i Bilancit	Shënime	2016	2015
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>		<b>489,828,243</b>	<b>202,824,862</b>
<b>I</b>	<b>Aktivët Afatshkurtra</b>		<b>52,871,639</b>	<b>45,672,801</b>
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>	<b>7</b>	<b>2,168,005</b>	<b>21,006,567</b>
<b>2</b>	<b>Investime :</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
a)	Në tituj pronësie të njërive ekonomike brenda grupit		-	-
b)	Aksionet e veta		-	-
c)	Të tjera financiare		-	-
	<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>3</b>	<b>Të drejta të arkëtueshme :</b>	<b>8</b>	<b>45,862,950</b>	<b>22,369,487</b>
a)	Nga aktiviteti i shfrytëzimit		2,729,935	-
b)	Nga njësitë ekonomike brenda grupit		106,080	-
c)	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
d)	Të tjera		43,026,935	22,369,487
e)	Kapital i nënshkruar i papaguar		-	-
	<b>Totali</b>		<b>45,862,950</b>	<b>22,369,487</b>
<b>4</b>	<b>Inventarët:</b>	<b>9</b>	<b>2,820,326</b>	<b>1,154,130</b>
a)	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		992,599	-
b)	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte		-	-
c)	Produkte të gatshme		1,448,633	-
d)	Mallra		-	-
e)	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)		379,094	1,154,130
f)	AAGJM të mbajtura për shitje		-	-
g)	Parapagime për inventar		-	-
	<b>Totali</b>		<b>2,820,326</b>	<b>1,154,130</b>
<b>5</b>	<b>Shpenzime të shtyra</b>	<b>10</b>	<b>2,020,358</b>	<b>1,142,618</b>
<b>6</b>	<b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>I-Aktive totale afatshkurtra</b>		<b>52,871,639</b>	<b>45,672,801</b>
<b>II</b>	<b>Aktive Afatgjata</b>		<b>436,956,604</b>	<b>157,152,061</b>
<b>1</b>	<b>Aktive financiare:</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
a)	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
b)	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		-	-
c)	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
d)	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-
e)	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		-	-
f)	Tituj të tjerë të huadhënies		-	-
	<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>2</b>	<b>Aktivët materiale:</b>	<b>11</b>	<b>436,828,218</b>	<b>157,152,061</b>
a)	Toka dhe ndërtesa		-	-
b)	Implante dhe makineri/ Mjete transporti		2,077,488	-
c)	Të tjera Instalime dhe pajisje		285,779,970	69,020,361
d)	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte		139,476,337	73,636,316
e)	Parapagime për aktive materiale dhe në proces		9,494,423	14,495,384
	<b>Totali</b>		<b>436,828,218</b>	<b>157,152,061</b>
<b>3</b>	<b>Aktive Biologjike</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>4</b>	<b>Aktive jo materiale:</b>		<b>128,386</b>	<b>-</b>
a)	Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		128,386	-
b)	Emri i Mirë		-	-
c)	Parapagime për AAJM		-	-
	<b>Totali</b>		<b>128,386</b>	<b>-</b>
<b>5</b>	<b>Aktive tatimore të shtyra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>II-Aktive totale afatgjata</b>		<b>436,956,604</b>	<b>157,152,061</b>
	<b>Aktive totale (I+II)</b>		<b>489,828,243</b>	<b>202,824,862</b>

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 31 Dhjetor 2016				në lekë	
	Zëri i Bilancit	Shënime	2016	2015	
<b>B</b>	<b>DETYRIME DHE KAPITALI</b>		<b>489,828,241</b>	<b>202,824,862</b>	
<b>I</b>	<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>61,984,412</b>	<b>94,037,517</b>	
<b>1</b>	<b>Detyrime afatshkurtra:</b>	<b>12</b>	<b>61,700,495</b>	<b>70,437,517</b>	
a)	Titujt e huamarrjes		-	-	
b)	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	a)	32,463,260	-	
c)	Arkëtimet në avancë për porosi		-	-	
d)	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	b)	3,331,371	27,753,843	
e)	Dëftesa të pagueshme		-	-	
f)	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	b)	25,013,489	42,211,795	
g)	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-	
h)	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	c)	328,187	469,712	
i)	Të pagueshme për detyrimet tatimore	d)	564,188	2,168	
j)	Të tjera të pagueshme		-	-	
	<b>Totali</b>		<b>61,700,495</b>	<b>70,437,517</b>	
<b>2</b>	<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>	<b>13</b>	<b>283,917</b>	<b>-</b>	
<b>3</b>	<b>Të ardhura të shtyra</b>	<b>14</b>	<b>-</b>	<b>23,600,000</b>	
<b>4</b>	<b>Provizione</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
	<b>I-Totali i Detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>61,984,412</b>	<b>94,037,517</b>	
<b>II</b>	<b>Detyrime afatgjata</b>		<b>232,375,709</b>	<b>118,941,462</b>	
<b>1</b>	<b>Detyrime afatgjata:</b>	<b>15</b>	<b>232,375,709</b>	<b>118,941,462</b>	
a)	Titujt e huamarrjes		-	-	
b)	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	a)	203,774,349	83,814,690	
c)	Arkëtimet në avancë për porosi		-	-	
d)	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		-	-	
e)	Dëftesa të pagueshme		-	-	
f)	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	b)	28,601,360	35,126,772	
g)	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		-	-	
j)	Të tjera të pagueshme		-	-	
	<b>Totali</b>		<b>232,375,709</b>	<b>118,941,462</b>	
<b>2</b>	<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>3</b>	<b>Të ardhura të shtyra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>4</b>	<b>Provizione:</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
a)	Provizione për pensionet		-	-	
b)	Provizione të tjera		-	-	
	<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>5</b>	<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
	<b>II-Totali i Detyrimeve afatgjata</b>		<b>232,375,709</b>	<b>118,941,462</b>	
	<b>Detyrime totale(I+II)</b>		<b>294,360,121</b>	<b>212,978,979</b>	
<b>III</b>	<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		<b>195,468,120</b>	<b>(10,154,117)</b>	
<b>1</b>	<b>Kapitali i Nënshkruar</b>		<b>203,310,000</b>	<b>100,000</b>	
<b>2</b>	<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>3</b>	<b>Rezerva rivlerësimi</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
<b>4</b>	<b>Rezerva të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	
a)	Rezerva ligjore		-	-	
b)	Rezerva statutore		-	-	
c)	Rezerva të tjera		-	-	
<b>5</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>		<b>(10,254,117)</b>	<b>(1,433,101)</b>	
<b>6</b>	<b>Fitim / Humbja e Vitit</b>		<b>2,412,237</b>	<b>(8,821,017)</b>	
	<b>III-Totali i Kapitalit</b>		<b>195,468,120</b>	<b>(10,154,117)</b>	
	<b>TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>489,828,241</b>	<b>202,824,862</b>	

**AGROCON ALBANIA**  
 Sh.p.k.  
 Nipt : L 32406024  
 TIRANË - ALBANIA

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

**2a1. Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)**

**Formati 1 - Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës**

N.r.	PËRSHKRIMI	Shenime	në lekë	
			2016	2015
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	4,229,570	-
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	17	(521,696)	-
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		213,325,385	-
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		150,445	
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(219,852,778)	-
a)	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	18	(6,527,393)	-
b)	Të tjera shpenzime	17	(213,325,385)	-
6	Shpenzime të personelit	19	(9,713,588)	(2,699,500)
a)	Paga dhe shpërblime		(8,380,543)	(2,388,302)
b)	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)		(1,333,045)	(311,198)
c)				-
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(6,380,236)	(1,168,918)
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	20	(8,354,892)	(5,260,672)
10	Të ardhura të tjera	21	23,615,750	400,000
a)	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			-
b)	Të ardhura nga njësiti ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësiti ekonomike brenda grupit)			-
c)	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësiti ekonomike brenda grupit)			-
d)	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësiti ekonomike brenda grupit)			-
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			-
12	Shpenzime financiare		6,490,561	(91,927)
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësiti ekonomike brenda grupit)		(108,428)	(130,781)
b)	Shpenzime të tjera financiare		(315,260)	38,855
c)	Fitimet (humbjet) nga kembimet valutare		6,914,249	-
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			-
	<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>		<b>2,988,521</b>	<b>(8,821,017)</b>
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(576,284)	-
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	22	(576,284)	
b)	Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
	<b>Fitimi/Humbja e vitit</b>		<b>2,412,237</b>	<b>(8,821,017)</b>
	<b>Fitimi/Humbja për:</b>			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		2,412,237	(8,821,017)
	Interesat jo-kontrolluese		-	-

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

**3.b. Pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur me 31 Dhjetor 2016**

*Sipas metodës indirekte*

	Shënime	2016	2015
<b>A</b>	<b>Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
1	Fitimi para tatimit	2,988,521	(8,821,017)
	Rregullimet për :		
2	Amortizimin	6,380,236	1,168,918
3	Të ardhura nga investimet		
4	Të ardhura nga interesat		-
5	Shpenzime për interesa	108,711	-
6	(Rritje) / rënie në tepricën e kërkesave të arketueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arketueshme të tjera	(24,371,203)	(23,487,104)
7	(Rritje) / rënie në tepricën e inventarit	(1,666,196)	(1,154,130)
8	(Rritje) / rënie në tepricën detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	132,168,223	127,801,783
9	Paratë e perfituara nga aktivitetet		
10	Interesi i arketuar / (paguar)	(108,711)	-
11	Tatim fitimi i paguar	(576,284)	
	Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	114,923,297	95,508,450
<b>B</b>	<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e investuese</b>		
1	Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(286,184,780)	(158,320,979)
3	Të ardhura nga shitja e paisjeve		
4	Interesi i arkëtuar		
5	Dividendët e arkëtuar		
	Paraja neto, e perdorur në aktivitetet e investuese	(286,184,780)	(158,320,979)
<b>C</b>	<b>Fluksi i parave nga veprimtaritë e financiare- Cash flows from financing activities</b>		
1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
2	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	119,959,659	83,814,690
3	Pagesat e detyrimeve të huave / qirasë financiare	32,463,260	-
4	Dividendë të paguar		
	Para neto e perdorur në aktivitetet financiare	152,422,919	83,814,690
	Rritja / (rënia) neto e mjeteve monetare	(18,838,564)	21,002,161
	Mjete monetare në fillim të periudhës kontabel	21,006,567	4,405
	Mjete monetare në fund të periudhës kontabel	7	2,168,003

**AGROCON ALBANIA**  
 Sh.p.k.  
 Nipt : L 32406024 O  
 TIRANË - ALBANIA

Shënime për pasqyrat financiare  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016  
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Agrocon Albania sh.p.k

**4.PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN QË MBYLLET MË 31 DHJETOR 2016**

b) në një pjesqyrë të pakonsoliduar

Në lekë

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesarit	Rezerva statutorë dhe ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali i Kapitaleve të veta
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2014</b>	<b>100,000</b>				<b>(1,433,101)</b>	<b>(1,333,101)</b>
Fitimi neto i vitit financiar					(8,960,865)	(8,960,865)
Rritje e rezervës kapitalit						
Emetimi i aksioneve	-					-
Dividendët e paguar						-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2015</b>	<b>100,000</b>	-	-	-	<b>(10,393,966)</b>	<b>(10,293,966)</b>
Fitimi neto i vitit financiar					2,412,237	2,412,237
Rritje e rezervës kapitalit						-
Emetimi i aksioneve	203,210,000					203,210,000
Dividendët e paguar						-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2016</b>	<b>203,310,000</b>	-	-	-	<b>(7,841,880)</b>	<b>195,468,120</b>

Roland KADIU

Administratori






## **5. Informacione te pergjitheshme**

“AGROCON ALBANIA“ sh.p.k. (“Shoqeria”) është krijuar me date 06 Dhjetor 2013 ne Qendren Kombetare te Regjistrimit si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me Nipt L32406024O, me ortak te vetem Balfin. Kapitali i nenshkruar mban vleren prej 68.240.000 leke, i perbere nga 100 kuota me vlere nominale 682,400 leke/sejcila. Ne daten 26.11.2014 shoqeria ka ndryshuar emrin e saj nga “Altracon” ne “Agrocon Albania”

Administrator i shoqerise me dt.31.12.2016 eshte Z. Roland Kadiu

## **6. Permbledhje e politikave kontabel**

### **Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

### **Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:**

#### **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

#### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kosos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2016 jane 1 Euro=135.23 leke

#### **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2016 eshte 15 % e njejte me ate qe ka qene ne ushtrimin e mëparshëm.



**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

---

**Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivët afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e perdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës fillestare dhe për aktivët e tjera 20% të vlerës së mbetur. Aktualisht amortizimi nuk është llogaritur për AMM që shoqëria ka në pronësi dhe përdorim.

**Amortizimi**

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

1. Ndertesa	5%	Metoda e vlerës së mbetur
2. Mjete Transporti	20%	Metoda e vlerës së mbetur
3. Instalime Teknike Secifik		Per investimet e kryera ne sera eshte aplikuar metoda linere
4. Mobilje, Orendi & Paisje	20 %	Metoda e vlerës së mbetur
5. Pajisje informatike	25%	Metoda e vlerës së mbetur
6. Te tjera	20%	Metoda e vlerës së mbetur

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsi trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivët në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.



**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

**7. AKTIVET MONETARE (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>a) Vlera ne arke</b>	<b>1,597,865</b>	<b>164,466</b>
<i>a.1 -Vlera ne leke ne arke</i>	<i>1,292,746</i>	<i>250,204</i>
<i>b.2 -Vlera ne euro ne arke</i>	<i>305,119</i>	<i>(85,738)</i>
<b>b) Vlera ne banke</b>	<b>570,140</b>	<b>20,842,101</b>
<i>b.1 - Vlera ne lek ne banke</i>	<i>458,929</i>	<i>14,714,531</i>
<i>b.2 - Vlera ne euro ne banke</i>	<i>111,211</i>	<i>6,127,570</i>
<b>Totali</b>	<b>2,168,005</b>	<b>21,006,567</b>

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive

**8. TE DREJTA TE ARKETUESHME**

Gjendjet e zerit te drejta te arketueshme ,ne fund te vitit ushtrimor rezulton si me poshte;

<b>Të drejta të arkëtueshme :</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
<i>Kliente per mallra</i>	<i>1,004,391</i>	-
<i>Parapagime te dhena</i>	<i>1,473,900</i>	-
<i>Kliente fatura te paderguara</i>	<i>251,644</i>	-
<i>Të pagueshme ndaj njësisive ekonomike brenda grupit</i>	<i>106,080</i>	-
<i>Të tjera</i>	<i>43,026,935</i>	<i>22,369,487</i>
<b>Totali</b>	<b>45,862,950</b>	<b>22,369,487</b>

**9. GJENDIA E INVENTARIT**

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.



**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

<b>Inventarët:</b>		<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
a)	<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	992,599	-
c)	<i>Produkte të gatshme</i>	1,448,633	-
d)	<i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)</i>	379,094	1,154,130
<b>Totali</b>		<b>2,820,326</b>	<b>1,154,130</b>

### 10. SHPENZIME TE SHTYRA

Ne kete ze eshte njohur shpenzimet per pleherimin organik te tokes , si edhe shpenzime financiare te huamarries

<b>Shpenzime të shtyra</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
<i>Shpenzime të shtyra</i>	2,020,358	1,142,618
<b>Totali</b>	<b>2,020,358</b>	<b>1,142,618</b>

### 11. PASQYRA E AKTIVEVE AFATGJATA

<b>Gjendjet dhe levizjet</b>	<b>Toka</b>	<b>Ndertesa</b>	<b>Aktive Afatgjata ne Proces</b>	<b>Makineri, Pajlaja dhe Instalime</b>	<b>Mjete Transporti</b>	<b>Moblje dhe pajlaja zyre</b>	<b>aktive afatgjata Jo - materiale</b>	<b>Totali</b>
<b>Vlera Bruto</b>								
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	70,135,121	-	54,158	-	70,189,279
<i>Shtesa</i>			137,554,471	223,085,275	2,416,750	1,897,519	136,720	364,890,735
<i>Transferime</i>			1,921,866	(1,921,866)				-
<i>Pakesime</i>						(142,558)		(142,558)
<b>31.12.2016</b>	-	-	139,476,337	291,298,530	2,416,750	1,809,119	136,720	434,937,456
<b>Amortizimi Akumuluar</b>								
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	1,136,887	-	-	-	1,136,887
<i>Shtesa</i>			-	5,932,036	339,262	65,546	8,334	6,345,178
<i>Pakesime</i>			-			(6,987)		(6,987)
<b>31.12.2016</b>	-	-	-	7,068,924	339,262	58,559	8,334	7,475,079
<b>Vlera Neto</b>								
<b>31.12.2015</b>	-	-	-	68,998,234	-	54,158	-	69,052,392
<b>31.12.2016</b>	-	-	139,476,337	284,229,606	2,077,488	1,550,560	128,386	427,462,377

### 12. DETYRIMET AFATSHKURTERA

Posti "Detyrime afatshkurtra" jepet i detajuar si meposhte:

- a) Zeri "Detyrime ndaj institucioneve të kredisë" : Ne kete grup perfshihen qera financiare afatshkurter per automejtet dhe hua afatshkurter,

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Qera financiare/leasing</i>	414,512	-
<i>Huamarrje afatshkurtra</i>	30,977,007	-
<b>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</b>	<b>31,391,519</b>	<b>-</b>

- b) Zeri "Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit" : Ne kete grup perfshihen detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve te cilet ne njohje fillestare jane vleresuar me kosto.

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Furnitore per mallra</i>	28,334,860	69,965,637
<i>Furnitor fatura te pamberritura</i>	10,000	-
<i>Të pagueshme ndaj njësitve ekonomike brenda grupit</i>	25,013,489	42,211,795
<b>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>28,344,860</b>	<b>69,965,637</b>

- c) Zeri "Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore" perfaqeson detyrimin e shoqerise per pagen e administratorit , e cila do te paguhet ne muajin Janar 2017

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Paga dhe shperblime</i>	43,271	384,576
<i>Paradhenie per punonjesit</i>	(75,000)	(17,500)
<i>Sigurime shoqerore dhe shendetsore</i>	359,916	102,636
<b>Të pagueshme ndaj punonjësve</b>	<b>328,187</b>	<b>469,712</b>

- d) Zeri "Te pagueshme per detyrime tatimore " perfaqeson detyrimin e kompanise per sigurimet shoqerore , TAP dhe tatimi ne burim muaji Dhjetor 2016. Ne kete ze, eshte zbritur parapagimi i kestit te tatim fitimit .

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Tatim mbi te ardhurat personale</i>	43,818	24,197
<i>Tatim qeraje</i>	4,086	-
<i>Tatim ne burim</i>	-	27,971
<i>tatimit mbi fitimin</i>	516,284	(50,000)
<b>Të pagueshme për detyrimet tatimore</b>	<b>564,188</b>	<b>2,168</b>

**13. TE PAGUESHME PER SHPENZIME TE KONSTATUARA**

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

Zeri "Të pagueshme për shpenzime të konstatuara" perfaqeson vleren shpenzimeve të njohur për të energjise elektrike Dhjetor 2016 :

<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
<i>Shpenzime të llogaritura</i>	283,917	-
<b>Totali</b>	<b>283,917</b>	<b>-</b>

**14. TE ARDHURA TE SHTYRA**

Zeri "Të ardhura të shtyra" shoqërohet gjatë vitit 2015 ka përfituar grante në vlerën 24,000,000 lekë, të cilën e kemi njohur në të ardhura gjatë vitit 2016

**15. DETYRIME AFATGJATA**

Posti "Detyrime afatgjata" jepet i detajuar si mëposhte:

- a) Zeri "Detyrime ndaj institucioneve të kredisë" : Në këtë grup përfshihen qera financiare afatgjate për automjetet dhe hua afatgjate.

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
<i>Qera financiare/leasing</i>	203,774,349	-
<i>Huamarrje afatshkurtra</i>	1,071,741	-
<b>Totali</b>	<b>204,846,090</b>	<b>-</b>

- b) Zeri "Të pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit" perfaqeson detyrimin e kompanisë ndaj ortakut të vetëm. Vlera e këtij detyrimi 28,601,360 Lekë.

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
<i>Ortaku</i>	28,601,360	35,126,772
<b>Totali</b>	<b>28,601,360</b>	<b>35,126,772</b>

**FTTIM HUMBJA**

**16. TE ARDHURA TE TJERA NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT**

Ky ze perfaqeson njohjen e të ardhurave nga shitja e produkteve bujqësore.

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Shitje produktesh</i>	4,229,570	-
<b>Totali</b>	<b>4,229,570</b>	<b>-</b>

**17. PUNA E KRYER NGA NJESIA EKONOMIKE**

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar</i>	213,325,385	-
<i>Të tjera shpenzime</i>	(213,325,385)	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**18. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME**

Ky ze perfaqeson shpenzime per blerje materiale te konsumueshme dhe lende e pare per aktivitetin e prodhimit.

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	6,527,393	-
<b>Totali</b>	<b>6,527,393</b>	<b>-</b>

**19. SHPENZIME PERSONELIT**

Shpenzimet per personelin detajet si me poshte per paga dhe per permbushjen e detyrimeve per sigurime shoqerore dhe shendetsore gjate vitit 2016.

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
